



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 15, datë 20.03.2015

PËR

**MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN NR. 110, DATË 28.07.2011
“PËR CAKTIMIN E NIVELIT TË PROVIGJONEVE TEKNIKE TË SIGURIMIT
TË DETYRUESHËM NË SEKTORIN E TRANSPORTIT”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si dhe të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, me propozim të Drejtorisë së Administrimit të Riskut dhe Departamentit të Çështjeve Juridike, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në Rregulloren nr. 110, datë 28.07.2011 “Për përcaktimin e nivelit të provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Enkeleda SHEHI

Ndryshimet në Rregulloren nr. 110, datë 28.07.2011 “Për përcaktimin e nivelit të provigjoneve teknike të sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”:

- Neni 2 “Baza ligjore”, referenca ndryshon si më poshtë:

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, dhe të nenit 10, të Ligjit nr. 10 076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar.

- Neni 3, pika 7 “Përkufizime”, referenca ndryshon si më poshtë:

“Aktuari i autorizuar” është personi i autorizuar nga AMF, sipas parashikimeve të nenit 4, pika 5 dhe nenit 222, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

- Neni 9, pika 1 “ Tarifat e primit të sigurimit” referenca ndryshon si më poshtë :

Primi i sigurimit përbëhet nga elementët e përcaktuar në nenin 87, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014. Shoqëria e sigurimit i përcakton vetë tarifat e primit për produktet e sigurimit të detyrueshëm motorik dhe njofton Autoritetin për tarifat e reja dhe çdo ndryshim në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.

- Neni 9, pika 3 “ Tarifat e primit të sigurimit” referenca ndryshon si më poshtë:

Në rast se shoqëria e sigurimit nuk njofton në Autoritet tarifat e ndryshuara, në Qendrën e Informacionit mbeten të fiksuara tarifat e mëparshme. Në rast se shoqëria zbaton tarifa të primit të sigurimit të detyrueshëm, më të ulëta se primi i rrezikut dhe nëse konstatohet se shoqëria e sigurimit jep sinjale për ulje të likuiditetit, si dhe rrezikon përmbushjen e rregullave të Menaxhimit të Rrezikut në përputhje me Ligjin nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Autoriteti merr masat konform dispozitave ligjore.